

## Thirrje për jurist/e

### Terma Reference:

Qendra Streha kërkon një jurist/e i cili do ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit LGBTI+ për të drejtat e tyre si dhe do të asistojë nevojat e tyre ligjore.

### Hyrje

Qendra "Streha" në kuadër të projektit *"Rritja e aksesit në shërbimet e ndihmës juridike dhe mbështetje psiko-sociale për personat LGBT në Shqipëri"*, pjesë e skemës së granteve të projektit *"Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri"* zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC), kërkon të punësojë një jurist/e i/e cili/a nëpërmjet ekspertizës së vet do ndihmojë në realizimin e sesioneve informuese mbi të drejtat e grupeve të marginalizuara me në fokus komunitetin LGBTI si dhe do të asistojë nevojat e tyre ligjore përgjatë periudhës së zbatimit të projektit.

### Informacion për Qendrën Streha

"Streha" është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri që i vjen në ndihmë komunitetit LGBTI+ përmes shërbimit konkret tranzitor për të gjithë të rinjtë LGBTI+, 18-29 vjeç, që hasin dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim për shkak të orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor. "Streha" ofron shërbime për fuqizimin dhe integrimin e individëve LGBTI+.

### Informacion për projektin

Projekti *"Rritja e aksesit në shërbimet e ndihmës juridike dhe mbështetje psiko-sociale për personat LGBT+ në Shqipëri"* synon përmirësimin e aksesit në drejtësi të të rinjve të grupeve të marginalizuara me një fokus të veçantë tek komuniteti LGBT+. Objektivi i përgjithshëm i projektit është Fuqizimi dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për të rinjtë e komunitetit LGBTI+, duke identifikuar dhe eliminuar pengesat që lidhen me këtë process.

Rezultatet e pritshme të këtij projekti janë:

1. 30 të rinjë të komunitetit LGBTI+ dhe grupeve të tjera të marginalizuara, do të informohen mbi legjislacionin që i mbron nga dhuna dhe diskriminimi dhe do të njihen me shërbimet për ta.
2. 30 të rinjë të komunitetit LGBTI+ do të ndihmohen me ofrimin e shërbimeve ligjore.

Në kuadër të këtij projekti, juristi/ja do të asistojë në kryerjen e sesioneve informuese mbi të drejtat dhe situatën e aksesit në drejtësi të të rinjve që janë pjesë e grupeve të marginalizuara me fokus të vecantë tek komuniteti LGBTI+, dhe do të ndjekë nevojat ligjore të të rinjve LGBTI+.

### **Përgjegjësitë e juristit/es:**

Në kuadër të këtij projekti, juristi/ja do jetë përgjegjës për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Së bashku me koordinatorin e projektit do të përgatiti sesionet për rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e komunitetit LGBTI+.
- Do të marrë pjesë në sesionet informuese që do të zhvillohen në qytetin e Lushnjes, Kavajës dhe Kukësit.
- Do të realizojë vlerësimin e nevojave ligjore të të rinjve dhe së bashku me menaxherin e rastit do plotësojë nevojat ligjore të personave LGBTI+.

### **Përgjegjësitë e Qendrës Streha**

- Të identifikojë të rinjtë pjesëmarrës në sesionet informuese.
- Të lehtësojë mbarëvajtjen e punës së ekspertit ligjorë dhe të ndërmjetësojë kontaktin e parë me përfituesit e mundshëm të projektit.

### **Kualifikimet**

- Studime pasuniversitare në Juridik.
- Të paktën 3 vjet përvojë pune relevante.
- Njohje shumë të mirë të Ligjit 10 221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Ligjit 9669 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” dhe çështje të tjera ligjore relevante për vlerësimin e situatës.

- Njohje shumë të mirë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Të ketë eksperiencë në ofrimin e shërbimit ligjorë grupeve të ndryshme të marxhinalizuara.
- Të jetë i/e aftë të respektojë afatet kohore dhe t’iu qëndrojë korrekt atyre.
- Të jetë fleksibel dhe tu përgjigjet nevojave të organizatës kontraktuese.
- Të njohë mirë gjuhët Shqip dhe Anglisht.

Koha e zhvillimit të projektit: **12 Muaj**

#### **Dorëzimi i aplikimeve**

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë me e-mail dokumentet e mëposhtme: a) letër interesi në Anglisht, b) cv në Anglisht

Dorëzimi i aplikimeve duhet të bëhet ne adresën [strehalgbt@gmail.com](mailto:strehalgbt@gmail.com), brenda datës **30.12.2022**.

*Vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do te njoftohen përmes emailit.*